



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

PROPOZIMIN KUVENDIT PËR LIRIMIN E NJË ANËTARI
DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT
TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Propozimin Kuvendit për lirim të z. Adrian Kamenica nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave.
2. Propozimin Kuvendit për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, si më poshtë vijon:
 - a) Z. Arbjan Mazniku, përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore;
 - b) Znj. Majlinda Dhuka, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
 - c) Znj. Oriana Arapi, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
 - ç) Znj. Albana Çami, përfaqësuese e botës akademike;
 - d) Znj. Eni Vasili, përfaqësuese e medias.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR LIRIMIN E NJË ANËTARI DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim propozimin Kuvendit për lirimin e një anëtari dhe propozimin e kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në Këshillin e Statistikave.

Këshilli i Statistikave është bord i përbërë nga njohës të fushës së statistikave. Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se programi i statistikave zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikën zyrtare.

Plotësimi i anëtarëve të bordit të Këshillit të Statistikave është i rëndësishëm për mirëfunksionimin e tij dhe për përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin nr.17/2018, “Për statistikën zyrtare”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim hartohet në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për garantimin e mirëfunksionimit të institucioneve shtetërore dhe të bordeve që mbështesin veprimtarinë e tyre.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim hartohet për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë me kapacitete të plota të Këshillit të Statistikave dhe për mundësimin e zbatimit me efikasitet të kornizës ligjore për mbledhjen, përpunimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, të parimeve statistikore, koordinimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe çështjeve të tjera që lidhen me statistikën zyrtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, dhe është në përputhje me parashikimet e vendimit nr.670, datë 7.11.2018, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk ka qëllim përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përmban dy pika, si më poshtë vijon:

1. Propozimin Kuvendit për lirimin e z. Adrian Kamenica nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave. Z. Kamenica propozohet të lirohet si anëtar i Këshillit të Statistikave, pasi aktualisht nuk është në radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrit.
2. Propozimin Kuvendit për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, si më poshtë vijon:
 - a) Z. Arbjan Mazniku, përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore;
 - b) Znj. Majlinda Dhuka, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
 - c) Znj. Oriana Arapi, përfaqësuese e përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
 - ç) Znj. Albana Çami, përfaqësuese e botës akademike;
 - d) Znj. Eni Vasili, përfaqësuese e medias.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryeministria.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare mbulohen nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

KËSHILLI I MINISTRAVE

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROPOZIMIN E KANDIDATURAVE PËRFAQËSUESE **PËR POZICIONIN E ANËTARËVE** **TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE**

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet shkresave nr.4087 prot., datë 28.12.2018, dhe nr.902 prot., datë 28.2.2019, i kërkoi Këshillit të Ministrave nisjen e procedurave për propozimin e kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante për pozicionin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave.

Këshilli i Statistikave është bord i përbërë nga njohës të fushës së statistikave. Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se programi i statistikave zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi, duke u bazuar në interesat profesionale për statistikat zyrtare si përdorues statistikash, si dhe në përvojën për metodat statistikore, proceset e krijimit të të dhënave ose për shkak të përfshirjeve të tjera në prodhimin e statistikave.

Mbështetur në pikën 3, të nenit 22, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, anëtarët e Këshillit të Statistikave, përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, të botës akademike, shoqërisë civile dhe medias propozohen nga Këshilli i Ministrave, bazuar në rregullat, kriteret dhe procedurat e miratuara me vendimin nr.670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

- Në përputhje me pikën 17, të vendimit nr.670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për fillimin e procedurave për plotësimin e vendeve vakante në Këshillin e Statistikave për:
 - a) 1 anëtar, përfaqësues nga organet e vetëqeverisjes vendore;
 - b) 1 anëtar, përfaqësues nga bota akademike;
 - c) 1 anëtar, përfaqësues të medias.

Në përputhje me pikën 2.2, të vendimit nr.670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, me urdhrin nr.5, datë 28.2.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, u ngrit Komisioni *ad-hoc* (në vijim, komisioni) për kryerjen e procedurave përzgjedhëse të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Statistikave, me këtë përbërje:

- Znj. Elira Kokona, anëtar, përfaqësues i Kryeministrit;
- Znj. Marbona Cuka, anëtar, përfaqësues i Kryeministrit;
- Z. Alban Çela, anëtar, përfaqësues i INSTAT-it.

Sipas parashikimeve të pikës 2.3, të vendimit nr.670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, njoftimi për aplikim u publikua në faqen e Kryeministrit, në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare. Me qëllim rritjen e numrit të aplikimeve, u rishpall njoftimi për aplikim dhe afati i pranimit të aplikimeve u shty deri më 4.4.2019.

Më poshtë, *link*-et ku u publikua njoftimi për aplikim:

<https://kryeministria.al/newsroom/njoftim-per-aplikim-8/>

http://www.instat.gov.al/media/5228/njoftim-p%C3%ABr-aplikim_k%C3%ABshilli-i-statistikave.pdf

<http://www.app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=7bf6d129-7712-456b-902d-139b3d2c0508>

<http://www.app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=b87ee855-99f7-4c0c-a0f9-3470383cc14f>

<https://kryeministria.al/newsroom/n-j-o-f-t-i-m-p-e-r-a-p-l-i-k-i-m-3/>

http://www.instat.gov.al/media/5398/njoftim-pe-r-aplikim_ke-shilli-i-statistikave_shtyhet-afati-i-aplikimit.pdf

Aplikimet janë gjithsej 7 (shtatë), respektivisht 4 (katër) aplikime nga përfaqësues të botës akademike, 2 (dy) aplikime nga përfaqësues të vetëqeverisjes vendore dhe 1 (një) aplikim nga përfaqësues të medias (renditur më poshtë për çdo kategori, sipas rendit alfabetik).

- *Aplikantët nga bota akademike:*

1. Aida Bendo;
2. Albana Çami;

3. Eneida Topulli;
4. Leontijev Çuçi.

- *Aplikantët nga vetëqeverisja vendore:*

1. Albert Jolle;
2. Arbjan Mazniku.

- *Aplikantët nga media:*

1. Eni Vasili.

Komisioni, pasi shqyrtoi dosjet dhe bëri verifikimet për përmbushjen e kriterëve, i paraqiti Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave listën e aplikantëve që përmbushin kriteret, për propozim në Këshillin e Ministrave, të renditur sipas vlerësimit të komisionit, në përputhje me përmbushjen e kriterëve të kërkuara, për çdo kategori, si më poshtë:

Përfaqësues të vetëqeverisjes vendore:

1. Arbjan Mazniku;
2. Albert Jolle.

Komisioni bëri këtë renditje, duke u bazuar në nivelin dhe natyrën e pozicionit aktual që mban secili nga aplikantët, në cilësinë e tyre si përfaqësues të vetëqeverisjes vendore.

Përfaqësues të botës akademike:

1. Albana Çami;
2. Leontijev Çuçi.

Komisioni bëri këtë renditje, duke u bazuar në kriterin e zotërimit të titullit më të lartë akademik nga aplikantët.

Përfaqësues të medias:

1. Znj. Eni Vasili.

Komisioni vlerësoi përvojën e spikatur dhe të gjatë të znj. Vasili në radhët e medias kombëtare.

Sekretari i Përgjithshëm vendosi të dërgojë për propozim në Këshillin e Ministrave aplikantin e renditur nga komisioni, të parin në listë, për çdo kategori.

- Anëtarët e Këshillit të Statistikave, të emëruar me vendimin nr.62, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, që janë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare dhe të cilëve u ka mbaruar mandati më 12.2.2019, janë, si më poshtë vijon:
 - Znj. Majlinda Dhuka – propozim i Këshillit të Ministrave (përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare);

Sipas pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, “Anëtarët e Këshillit të Statistikave, të emëruar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, gëzojnë mandatin pesëvjeçar nga momenti i emërimit të tyre në këtë detyrë, me të drejtë përsëritjeje vetëm një herë”.

Z. Adrian Kamenica – propozim i Këshillit të Ministrave (përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare) duhet zëvendësuar, sepse nuk është më në radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrit, në përputhje me pikën 6, të nenit 22, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

- Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, bazuar në rregullat, kriteret dhe procedurat e parashikuara në pikën 2.1, të vendimit 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, Këshilli i Ministrave i propozon Kuvendit lirim të një anëtarit dhe emërimin e disa anëtarëve të Këshillit të Statistikave, si më poshtë vijon:
 - Lirim të z. Adrian Kamenica nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave.
 - Anëtar i propozuar për të qenë përfaqësues i vetëqeverisjes vendore është z. Arbjan Mazniku, nënkryetar i Bashkisë Tiranë.
 - Anëtar i propozuar për të qenë përfaqësues i botës akademike është znj. Albana Çami, mbajtëse e titullit akademik “Prof. Dr”, përgjegjëse e grup-lëndëve të “Hyrjes në Ekonomi” në Departamentin e Ekonomisë, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

- Anëtari i propozuar për të qenë përfaqësues i medias është znj. Eni Vasili, gazetarë me përvojë të gjatë në radhët e medias kombëtare.
- Anëtarët e propozuar për të qenë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare janë znj. Majlinda Dhuka, drejtor i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, dhe znj. Oriana Arapi, drejtor i Njesisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, në Kryeministri.

Këto kandidatura përbëjnë garanci profesionale në arritjen e objektivave të përcaktuar në fushën e statistikave dhe në përmbushjen me sukses të detyrës që do t'u ngarkohet.

Bashkëlidhur do të gjeni *curriculum vitae*-t e tyre.